



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr.81

2005

1 nëntor

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i Kuvendit nr.8, datë 20.10.2005	Për ngritjen e Komisionit Hetimor të Kuvendit për zbatimin e legjislacionit në përgatitjen dhe zhvillimin e procesit zgjedhor të datës 3 korrik 2005	2679
Dekret nr.4649 datë 29.9.2005	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	2680
Dekret nr.4668 datë 18.10.2005	Për lejim lënie të shtetësisë shqiptare.....	2681
Dekret nr.4669 datë 20.10.2005	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	2682
Dekret nr.4677 datë 28.10.2005	Për emërimin e Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit.....	2682
Vendim i AMS nr.32, datë 26.9.2005	Për njohjen e programit të testimit profesional për akuaret në sigurime.....	2683
Vendim i AMS nr.33, datë 26.9. 2005	Mbi analizën e gjendjes financiare të shoqërisë së sigurimeve “INSIG” sh.a. për vitin 2004.....	2683
Vendim i AMS nr.34, datë 26.9.2005	Mbi analizën e gjendjes financiare të shoqërisë së sigurimeve “SIGMA” sh.a. për vitin 2004.....	2684

Vendim i AMS nr.35, datë 26.9.2005	Mbi analizën e gjendjes financiare të shoqërisë së sigurimeve “SIGAL” sh.a. për vitin 2004.....	2685
Vendim i AMS nr.36, datë 26.9.2005	Mbi analizën e gjendjes financiare të shoqërisë së sigurimeve “ATLANTIK” sh.a. për vitin 2004.....	2685
Vendim i AMS nr.37, datë 26.9.2005	Mbi analizën e gjendjes financiare të shoqërisë së sigurimeve “INTERSIG” sh.a. për vitin 2004.....	2686
Vendim i AMS nr.38, datë 27.9.2005	Mbi zbatimin e masave korrigjuese nga shoqëria e sigurimeve “INTERSIG” sh.a.....	2687
Vendim i AMS nr.39, datë 25.10.2005	Për kalimin në risigurim të klasës 10 të sigurimit.....	2687
Vendim i AMS nr.40, datë 26.10.2005	Mbi analizën e gjendjes financiare të shoqërisë së sigurimeve “DUKAGJINI AL” sh.a. për 6- mujorin e parë të vitit 2005....	2688
Vendim i AMS nr.41, datë 26.10.2005	Mbi analizën e gjendjes financiare të shoqërisë së sigurimeve “ALBSIG” sh.a. për 6- mujorin e parë të vitit 2005.....	2689
Vendim i AMS nr.42, datë 26.10.2005	Mbi analizën e gjendjes financiare të shoqërisë së sigurimeve “INTERALBANIAN” sh.a. për 6- mujorin e parë të vitit 2005	2690
Vendim i AMS nr.43, datë 26.10.2005	Për nivelin e fondit të garancisë së kërkuar për shoqërinë e sigurimit “INTERSIG” sh.a.....	2691

VENDIM
Nr.8, datë 20.10.2005

**PËR NGRITJEN E KOMISIONIT HETIMOR TË KUVENDIT PËR ZBATIMIN E
LEGJISLACIONIT NË PËRGATITJEN DHE ZHVILLIMIN E PROCESIT ZGJEDHOR
TË DATËS 3 KORRIK 2005**

Në mbështetje të neneve 77 dhe 78 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.8891, datë 2.5.2002 “Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit”, me propozimin e një grupi deputetësh,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Ngrihet Komisioni Hetimor i Kuvendit për hetimin e zbatimit të legjislacionit në përgatitjen dhe zhvillimin e procesit zgjedhor të datës 3 korrik 2005.

II. Objekti dhe fusha e veprimit të këtij komisioni hetimor duhet të respektojë parimet kushtetuese dhe normat e gjithëpranuara të së drejtës ndërkombëtare, duke mos cenuar pavarësinë dhe veprimtarinë e organeve të tjera. Këto parime përjashtojnë çdo formë kontrolli parlamentar mbi veprimtarinë juridiksionale të gjykatave.

III. Objekt i hetimit të Komisionit Hetimor Parlamentar është:

a) hetimi i akuzave publike për moszbatimin e legjislacionit zgjedhor në zgjedhjet e datës 3 korrik 2005 nga Komisionet e Qendrave të Votimit, Komisionet e Zonave Zgjedhore dhe Grupet e Numërimit të Votave;

b) Zbatimi i dispozitave të Kodit Zgjedhor dhe akteve të dala në zbatim të tij, në lidhje me procesin e numërimit të votave për partitë politike dhe koalicionet nga Grupet e Numërimit të Votave, si dhe pasqyrimi i tabelave të rezultateve të grupeve të numërimit në procesverbalin përfundimtar të hartuar nga KZZ-ja;

c) përdorimi i certifikatave të lindjes për votim në datën 3 korrik 2005 në qarkun e Tiranës, në qarkun e Durrësit dhe në qarkun e Beratit, si dhe hetimi i akuzave publike për përdorimin e certifikatave false në këto votime;

ç) hetimi i rrethanave të nxjerrjes së urdhrit të Ministrit të Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit nr.166, datë 30.12.2004, me nr.5787 prot. “Për kodet e certifikatave të lindjes lëshuar nga zyrat e gjendjes civile” dhe pasojat e tij në procesin zgjedhor;

d) aktet e nxjerra nga Ministria e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit lidhur me hartimin e listave të zgjedhësve, procedurat e ndjekura për hartimin e listave të zgjedhësve dhe gjendja e tyre; heqja në mënyrë të qëllimshme e zgjedhësve nga listat e tyre dhe dublikimet;

dh) shkelja e dispozitave ligjore të Kodit Zgjedhor në njësitë e qeverisjes vendore në Kolonjë, Berat, Përmet dhe Skrapar, lidhur me kriterin numerik minimal për caktimin e qendrave të votimit;

e) përdorimi i burimeve të administratës publike gjatë fushatës zgjedhore; rasti i dhënies së tokës në komunën Ksamil;

ë) përdorimi i dhunës nga bandat e armatosura në zonën zgjedhore nr.62 Lushnjë, në zonën nr.90 Gjirokastrë dhe në zona të tjera dhe veçanërisht në zonën nr.37 Tiranë, në të cilën u vra zoti Vathi-vëzhgues i Partisë Demokratike në qendrën e votimit;

f) financimet në kundërshtim dhe në tejkalim të dispozitave ligjore nga kandidatët për deputetë.

IV.Komisioni përbëhet nga:

1.Arben Isaraj
2.Bujar Nishani

Kryetar
zëvendëskryetar

3.Paskal Milo	anëtar
4.Blendi Klosi	“
5.Rajmonda Stefa	“
6.Neritan Ceka	“
7.Ndre Legisi	“
8.Engjëll Bejtaj	“
9.Ylli Pango	“
10.Ferdinand Xhaferi	“
11.Astrit Patozi	“
12.Ymer Tola	“
13.Arjan Madhi	“
14.Nikollë Lesi	“
15.Aurel Bylykbashi	“

V. Komisioni Hetimor e ushtron veprimtarinë e tij për një periudhë tremujore, duke filluar nga data e miratimit të këtij vendimi.

VI. Ngarkohet Kryetarja e Kuvendit të caktojë mjediset dhe mjetet e punës së Komisionit Hetimor.

VII. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

DEKRET Nr.4649, datë 29.9.2005

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92 pika “c” të Kushtetutës, të nenit 20 dhe të nenit 9 pika 7 të ligjit nr.8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare,

DEKRETOJ:

Neni 1

U jepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

- | | |
|------------------------------------|---------------------------------------|
| 1. Hasan Riza Ukëhaxhaj | 14. Farije Smajl Ukëhaxhaj (Tahiraj) |
| 2. Ajshe Zymer Ukëhaxhaj (Hulaj) | 15. Fatime Qazim Ukëhaxhaj (Qallakaj) |
| 3. Shkëlzen Hasan Ukëhaxhaj | 16. Isuf Jahë Ukëhaxhaj |
| 4. Rinesa Shkëlzen Ukëhaxhaj | 17. Donikë Isuf Ukëhaxhaj |
| 5. Syzanë Shpend Ukëhaxhaj (Muçaj) | 18. Valbona Isuf Ukëhaxhaj |
| 6. Albert Hasan Ukëhaxhaj | 19. Kosovare Isuf Ukëhaxhaj |
| 7. Butrint Albert Ukëhaxhaj | 20. Xheve Brahim Ukëhaxhaj (Osmonaj) |
| 8. Arjeta Ali Ukëhaxhaj | 21. Torvioll Isuf Ukëhaxhaj |
| 9. Berat Hasan Ukëhaxhaj | 22. Ajshe Sylë Ukëhaxhaj (Zukaj) |
| 10. Vjosa Hasan Ukëhaxhaj | 23. Drilon Faik Ukëhaxhaj |
| 11. Fatmir Jahë Ukëhaxhaj | 24. Jetmira Faik Ukëhaxhaj |
| 12. Arbnore Fatmir Ukëhaxhaj | 25. Doruntina Faik Ukëhaxhaj |
| 13. Tauland Fatmir Ukëhaxhaj | |

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

DEKRET
Nr.4668, datë 18.10.2005

PËR LEJIM LËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92 pika “c” të Kushtetutës, të neneve 15,19 dhe 20 të ligjit nr.8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Rendit Publik

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

- | | |
|--|----------------------------------|
| 1. Helena Apostol Bella (Koçi) | 21. Dhurata Adem Batriu (Dragoj) |
| 2. Edlira Ilmi Canko (Vasha) | 22. Skënder Islam Lleshi |
| 3. Nermin Ramazan Stërmasi | 23. Shpresa Xhemal Lleshi (Luga) |
| 4. Edvin Hamza Domi | 24. Dhurata Mustafa Allushi |
| 5. Habib Refat Beshka | 25. Loreta Fasli Pecina (Silaj) |
| 6. Nico Dirk Habib Beshka | 26. Muharrem Adem Lila |
| 7. Luca Philip Habib Beshka | 27. Shkëlqim Kontroll Caushaj |
| 8. Floresha Qani Shani | 28. Vitore Tom Gruhn (Nikolla) |
| 9. Klaudia Gon Qelia | 29. Imelda Veli Kuka (Lala) |
| 10. Taulant Enver Sopjani | 30. Lavdi Eqerem Vorpsi |
| 11. Roland Ramiz Stefi | 31. Enxhi Lavdi Vorpsi |
| 12. Alma Xhoxhi Gjergji (Konomi) | 32. Margen Lavdi Vorpsi |
| 13. Andi Maksim Gjergji | 33. Alketa Bujar Estrefi (Cacaj) |
| 14. Myzejen Demir Tafani | 34. Michael Flamur Estrefi |
| 15. Kujtim Mersin Sopaj | 35. Chris Flamur Estrefi |
| 16. Blerta Xhevat Lila (Murtaj) | 36. Artur Jak Jaku |
| 17. Henri Ramadam Lila | 37. Besa Hamdi Gojani |
| 18. Eris Bajram Toska | 38. Igli Altin Guzi |
| 19. Haligert Edmond Gega | 39. Mimoza Mehmet Müller (Hasa) |
| 20. Benereta Qemal Neuhaus (Abasllari) | 40. Ilir Bardhosh Xhelili |

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

DEKRET
Nr.4669, datë 20.10.2005

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, pika “c”, të Kushtetutës, të nenit 20 dhe të nenit 9 të ligjit ntr.8389, datë 5.8.1998, “Për shtetësinë shqiptare”, bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Rendit Publik,

DEKRETOJ:

Neni 1

U jepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Xhevat Mursel Dautaj
2. Duro Ismail Shehu
3. Arben Mersim Pollozhani
4. Lutvije Xhemil Zulali
5. Ildiko Laszlo Benussi (Nagy)
6. Ramadan Husni Rexhepi
7. Bozho Jagosh Matanoviq
8. Aleksandër Jagosh Matanoviq
9. Daniela-Carmen Eduard-Dan Stoica
10. Lavdije Xhevdet Hajredini-Ibraimi
11. Ciro Michelangelo Donzella

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Alfred Moisiu

DEKRET
Nr.4677, datë 28.10.2005

PËR EMËRIMIN E AVOKATIT TË PËRGJITHSHËM TË SHTETIT

Në mbështetje të nenit 93 të Kushtetutës, si dhe të nenit 8 të ligjit nr.8551, datë 18.11.1999 “Për avokaturën e shtetit”, me propozim të Kryeministrit,

DEKRETOJ:

Neni 1

Z. Artan Kodheli emërohet Avokat i Përgjithshëm i Shtetit.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Alfred Moisiu

VENDIM
Nr.32, datë 26.9.2005

**PËR NJOHJEN E PROGRAMIT TË TESTIMIT PROFESIONAL PËR AKTUARET
NË SIGURIME**

Në mbështetje të shkronjës “k” të nenit 14 të ligjit nr.9268, datë 29.7.2004 “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve” dhe të nenit 66 të ligjit nr.9267, datë 29.7.2004 “Për veprimtarinë e sigurimit, risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime”, Këshilli i Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve

VENDOSI:

1. Çeljen e kursit të trajnimit të aktualeve në sigurime pranë Autoritetit Mbikëqyrës të sigurimeve.
2. Miratimin e programit të testimit profesional për aktualet në sigurime të paraqitur nga FSVC (Financial Services Voluntary Corps) sipas aneksit nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
3. Të pranohet oferta e FSVC-së për të financuar kursin.
4. Ngarkohet Autoriteti Mbikëqyrës i Sigurimeve të përcaktojë kriteret për dhënien e autorizimit aktualeve në sigurime në bashkëpunim me Fakultetin e Shkencave të Natyrës dhe Fakultetin e Ekonomisë.
5. Ky vendim t'i dërgohet FSVC-së, Fakultetit të Ekonomisë dhe Fakultetit të Shkencave të Natyrës, Tiranë dhe shoqërive të sigurimit.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE E KËSHILLIT
TË AUTORITETIT MBIKËQYRËS TË SIGURIMEVE
Burbuqe Riba

VENDIM
Nr.33, datë 26.9. 2005

**MBI ANALIZËN E GJENDJES FINANCIARE TË SHOQËRISË
SË SIGURIMEVE “INSIG” SHA PËR VITIN 2004**

Në mbështetje të shkronjave “d”, “ë”, “k” të pikës 2 të nenit 14 të ligjit nr.9268, datë 29.7.2004 “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Mbikëqyrës së Sigurimeve”, nenit 93 të ligjit nr.9267, datë 29.7.2004 “Për veprimtarinë e sigurimit, risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime” dhe të ligjit “Për kontabilitetin”, pasi shqyrtoi materialet e përgatitura nga organi ekzekutiv, në bashkëpunim me këshilltarin financiar të Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve, shoqërinë audituese ndërkombëtare Price Water House Coopers, Këshilli i Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve

VENDOSI:

1. T'i kërkohet shoqërisë së sigurimeve INSIG sh.a. të krijojë rezervën e sigurisë në vlerën 21 767 426 lekë që përbën 1/3 e fitimit të vitit ushtrimor 2004;
2. Shoqëria e sigurimeve INSIG sh.a. të bëjë provigjonimin e debitorëve në shumën 7 561 845 si më poshtë:
 - a) Debitore administrata 4 166 983 lekë;
 - b) Debitore agjente për licencim 3 394 862 lekë.
3. Kërkesat e parashikuara në pikat 1 dhe 2 të këtij vendimi të pasqyrohen nga shoqëria e sigurimeve INSIG sh.a. në pasqyrat financiare deri në 31.12.2005.
4. Ngarkohet shoqëria e sigurimeve INSIG sh.a. dhe Drejtoria e Mbikëqyrjes dhe Inspektimit në Autoritetin Mbikëqyrës të Sigurimeve për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi më datë 26.9.2005.

KRYETARE E KËSHILLIT
TË AUTORITETIT MBIKËQYRËS TË SIGURIMEVE
Burbuqe Riba

VENDIM
Nr.34, datë 26.9.2005

**MBI ANALIZËN E GJENDJES FINANCIARE TË SHOQËRISË SË SIGURIMEVE “SIGMA”
SHA PËR VITIN 2004**

Në mbështetje të shkronjave “d”, “ë”, “k” të pikës 2 të nenit 14 të ligjit nr.9268, datë 29.7.2004 “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Mbikëqyrës së Sigurimeve”, nenet 111, 126 të ligjit nr.9267, datë 29.7.2004 “Për veprimtarinë e sigurimit, risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime” dhe të ligjit “Për kontabilitetin”, pasi shqyrtoi materialet e përgatitura nga organi ekzekutiv, në bashkëpunim me këshilltarin financiar të Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve shoqërinë audituese ndërkombëtare Price Water House Coopers, Këshilli i Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve

VENDOSI:

1. Shoqëria e sigurimeve SIGMA sh.a. për arritjen e nivelit të kërkuar të aftësisë paguese të llogaritur në shumën 184 185 936 lekë, të paraqesë në Autoritetin Mbikëqyrës të Sigurimeve një plan masash, për arritjen e këtij niveli, brenda 10 ditëve nga data e marrjes së njoftimit për këtë vendim, duke përfshirë objektivat dhe mënyrat e realizimit të tyre, si dhe afatet përkatëse.

2. Shoqëria e sigurimeve SIGMA sh.a. të përmbushë planin e masave brenda 3 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

3. Shoqëria e sigurimeve SIGMA sh.a. ndalohet të shpërndajë fitim për vitin 2004. Fitimi i vitit ushtrimor 2004 të shkojë për rritjen e kapitalit të shoqërisë SIGMA sh.a.

4. Shoqëria e sigurimeve SIGMA sh.a. të bëjë provigjionimin për shumën 56 647 070 lekë si më poshtë:

Paradhënie	6 000 000 lekë;
Debitorë	50 647 070 lekë.

5. Ngarkohet shoqëria e sigurimeve SIGMA sh.a. dhe Drejtoria e Mbikëqyrjes dhe Inspektimit në Autoritetin Mbikëqyrës të Sigurimeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi më datë 26.9.2005.

KRYETARE E KËSHILLIT
TË AUTORITETIT MBIKËQYRËS TË SIGURIMEVE
Burbuqe Riba

VENDIM
Nr.35, datë 26.9.2005

**MBI ANALIZËN E GJENDJES FINANCIARE TË SHOQËRISË SË SIGURIMEVE “SIGAL”
SHA PËR VITIN 2004**

Në mbështetje të shkronjave “d”, “ë”, “k” të pikës 2 të nenit 14 të ligjit nr.9268, datë 29.7.2004 “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Mbikëqyrës së Sigurimeve”, nenet 93 dhe 111 të ligjit nr.9267, datë 29.7.2004 “Për veprimtarinë e sigurimit, risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime” dhe të ligjit “Për kontabilitetin”, pasi shqyrtoi materialet e përgatitura nga organi ekzekutiv, në bashkëpunim me këshilltarin financiar të Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve, shoqërinë audituese ndërkombëtare Price Water House Coopers, Këshilli i Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve

VENDOSI:

1. Ti kërkohet shoqërisë së sigurimeve SIGAL sh.a. të krijojë rezervën e sigurisë në shumën

37 087 891 lekë që përbën 1/3 (një të tretën) e fitimit të vitit ushtrimor 2004.

2. Shoqëria e sigurimeve SIGAL sh.a. të bëjë provigjionimin për shumën e debitorëve në vlerë totale 10 369 853 lekë.

3. Kërkesat e pikave 1 dhe 2 të këtij vendimi të pasqyrohen nga shoqëria e sigurimeve SIGAL sh.a. në pasqyrat financiare deri më 31.12.2005.

4. Ngarkohet shoqëria e sigurimeve SIGAL sh.a. dhe Drejtoria e Mbikëqyrjes dhe Inspektimit në Autoritetin Mbikëqyrës të Sigurimeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi më datë 26.9.2005.

KRYETARE E KËSHILLIT
TË AUTORITETIT MBIKËQYRËS TË SIGURIMEVE
Burbuqe Riba

VENDIM
Nr.36, datë 26.9.2005

MBI ANALIZËN E GJENDJES FINANCIARE TË SHOQËRISË SË SIGURIMEVE
“ATLANTIK” SHA PËR VITIN 2004

Në mbështetje të shkronjave “d”, “ë”, “k” të pikës 2 të nenit 14 të ligjit nr. 9268, datë 29.7.2004 “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Mbikëqyrës së Sigurimeve”, nenet 93 dhe 111 të ligjit nr.9267, datë 29.7.2004 “Për veprimtarinë e sigurimit, risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime” dhe të ligjit “Për kontabilitetin”, pasi shqyrtoi materialet e përgatitura nga organi ekzekutiv, në bashkëpunim me këshilltarin financiar të Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve, shoqërinë audituese ndërkombëtare Price Water House Coopers, Këshilli i Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve

VENDOSI:

1. T’i kërkohet shoqërisë së sigurimeve ATLANTIK sh.a. të krijojë rezervën e sigurisë në shumën 12 042 603 lekë që përbën 1/3 (një të tretën) e fitimit të vitit ushtrimor 2004.

2. Shoqëria e sigurimeve ATLANTIK sh.a. të bëjë provigjionimin për shumën e debitorëve në vlerë totale 9 579 635 lekë.

3. Kërkesat e pikave 1 dhe 2 të këtij vendimi të pasqyrohen nga shoqëria e sigurimeve ATLANTIK sh.a. në pasqyrat financiare deri më 31.12.2005.

4. Ngarkohet shoqëria e sigurimeve ATLANTIK sh.a. dhe Drejtoria e Mbikëqyrjes dhe Inspektimit në Autoritetin Mbikëqyrës të Sigurimeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi më datë 26.9.2005.

KRYETARE E KËSHILLIT
TË AUTORITETIT MBIKËQYRËS TË SIGURIMEVE
Burbuqe Riba

VENDIM
Nr.37, datë 26.9.2005

MBI ANALIZËN E GJENDJES FINANCIARE TË SHOQËRISË SË SIGURIMEVE
“INTERSIG” SHA PËR VITIN 2004

Në mbështetje të shkronjave “d”, “ë”, “k” të pikës 2 të nenit 14 të ligjit nr.9268, datë 20.7.2004 “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Mbikëqyrës së Sigurimeve”, nenet 93 dhe

111 të ligjit nr.9267, datë 29.7.2004 "Për veprimtarinë e sigurimit, risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime" dhe të ligjit "Për kontabilitetin", pasi shqyrtoi materialet e përgatitura nga organi ekzekutiv në bashkëpunim me këshilltarin financiar të Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve, shoqërinë audituese ndërkombëtare Price Water House Coopers, Këshilli i Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve

VENDOSI:

1. T'i kërkojë shoqërisë së sigurimeve INTERSIG sh.a:
 - a) Të paraqesë në Autoritet pasqyrat financiare të vitit 2004 sipas standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit (IFRS) të shoqëruara me raport auditimi të këtyre pasqyrave financiare të lëshuara nga një shoqëri audituese ndërkombëtare.
 - b) Të krijojë rezervën e sigurisë në shumën 29 013 965 lekë që përbën 1/3 (një të tretën) e fitimit të vitit ushtrimor 2004.
 2. Shoqëria e sigurime INTERSIG sh.a. ndalohet të shpërndajë fitim për vitin ushtrimor 2004.
 3. Shoqëria e sigurimeve INTERSIG sh.a. të bëjë arkëtimin e paradhënies ndaj znj. Ilda Pitarka në shumën 28 792 100 lekë. Ky arkëtim të realizohet brenda 10 ditëve kalendarike nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
 4. Shoqëria e sigurimeve INTERSIG sh.a. të marrë masa urgjente për uljen e gjendjes së likuiditeteve në arkë. Gjendja e likuiditeteve në arkë të jetë jo më shumë se 5 733 669 lekë që përbën 3% të provigjionit teknik, në përputhje me vendimin të Këshillit të Ministrave nr.268, datë 28.4.2005 "Për përcaktimin e kufijve maksimalë të lejueshëm për aktivet dhe investimet e aktiveve, për mbulimin e provigjioneve teknike dhe matematike nga shoqëritë e sigurimit".
 5. Ngarkohet shoqëria e sigurimeve INTERSIG sh.a. dhe Drejtoria e Mbikëqyrjes dhe Inspektimit në Autoritetin Mbikëqyrës të Sigurimeve për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi më datë 26.9.2005.

**KRYETARE E KESHILLIT
TË AUTORITETIT MBIKËQYRËS TË SIGURIMEVE
Burbuqe RIBA**

**VENDIM
Nr.38, datë 27.9.2005**

**MBI ZBATIMIN E MASAVE KORRIGJUESE NGA SHOQËRIA E SIGURIMEVE
"INTERSIG" SHA**

Në mbështetje të shkronjave "ç" dhe "k" të pikës 2 të nenit 14 të ligjit nr.9268, datë 29.7.2004 "Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Mbikëqyrës së Sigurimeve" dhe të shkronjës "ë" të nenit 124 dhe të nenit 126 të ligjit nr.9267, datë 29.7.2004 "Për veprimtarinë e sigurimit, risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime" për shkelje të rënda të rregullave të menaxhimit të shoqërisë së sigurimeve INTERSIG sh.a, të përcaktuara në germenat "ç", "d" dhe "e" të pikës 3 të nenit 126 të ligjit nr. 9267, datë 29.7.2004, si dhe për shkelje të neneve 101 pika 1 dhe 118 të ligjit nr.9267, datë 29.7.2004, Këshilli i Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve

VENDOSI:

1. Të urdhërojë shoqërinë e sigurimeve INTERSIG sh.a. që brenda 30 ditëve nga data e këtij vendimi të realizojë:
 - a) Uljen e likuiditeteve në arkë deri në masën 3% të provigjioneve teknike të miratuara me vendimin e Këshillit të Autoritetit Mbikëqyrës së Sigurimeve nr.20, datë 1.4.2005.
 - b) Arkëtimin e paradhënies dhënë personave fizikë ose juridikë.
 - c) Rritjen e kapitalit themeltar të shoqërisë së sigurimit INTERSIG sh.a. në zbatim të

kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe detyrimeve që burojnë nga përgjegjësitë e marra në sigurim.

2. Rritjen e vlerës së provigjoneve teknike në shumën 191 122 321 lekë të miratuar me vendimin e Këshillit të Autoritetit Mbikëqyrës së Sigurimeve nr.20, datë 1.4.2005.

3. Në zbatim të nenit 128 të ligjit 9267, datë 29.7.2004 në rast se shoqëria INTERSIG sh.a. nuk i plotëson masat e parashikuara në këtë vendim, Autoriteti do të procedojë me masën e tërheqjes së licencës për ushtrimin e veprimtarisë së sigurimeve.

4. Vendimi të shqyrtohet nga organet drejtuese të shoqërisë dhe masat e marra në zbatim të tij t'i njoftohen Autoritetit.

Ky vendim hyn në fuqi më 27.9.2005.

KRYETARE E KËSHILLIT
TË AUTORITETIT MBIKËQYRËS TË SIGURIMEVE
Burbuqe Riba

VENDIM
Nr.39, datë 25.10.2005

PËR KALIMIN NË RISIGURIM TË KLASËS 10 TË SIGURIMIT

Në mbështetje të shkronjave "d" dhe "k" të pikës 2, nenit 14 të ligjit nr.9268, datë 29.7.2004 "Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Mbikëqyrës së Sigurimeve", nenin 107, 108 të ligjit nr.9267, datë 29.7.2004 "Për veprimtarinë e sigurimit, risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime", dekretit nr.295, datë 15.9.1992 "Për sigurimin e detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorike për përgjegjësinë ndaj personave të tretë", me propozim të organit ekzekutiv, Këshilli i Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve

VENDOSI:

1. Shoqëritë e Sigurimit SIGMA SHA, SIGAL SHA, ATLANTIK SHA, INTERSIG SHA, DUKAGJIN AL SHA, INTERALBANIAN SHA dhe ALBSIG SHA, detyrohen të kalojnë në risigurim portofolin e sigurimit të detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorike për përgjegjësitë ndaj personave të tretë (përfshirë kartonin jeshil), brenda 1 muaji nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendim.

2. Ngarkohen shoqëritë e sigurimit SIGMA SHA, SIGAL SHA, ATLANTIK SHA, INTERSIG SHA, DUKAGJIN AL SHA, INTERALBANIAN SHA dhe ALBSIG SHA, dhe Drejtoria e Mbikëqyrjes dhe Inspektimit në Autoritetin Mbikëqyrës të Sigurimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi më datë 25.10.2005.

KRYETARE E KËSHILLIT
TË AUTORITETIT MBIKËQYRËS TË SIGURIMEVE
Burbuqe Riba

VENDIM
Nr.40, datë 26.10.2005

MBI ANALIZËN E GJENDJES FINANCIARE TË SHOQËRISË SË SIGURIMEVE
"DUKAGJINI AL" SHA PËR 6- MUJORIN E PARË TË VITIT 2005

Në mbështetje të shkronjave "d" dhe "k" të pikës 2 të nenit 14 të ligjit nr.9268, datë 29.7.2004 "Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Mbikëqyrës së Sigurimeve", nenit 107 dhe 175, pika

2 të ligjit nr.9267, datë 29.7.2004 "Për veprimtarinë e sigurimit, risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime", pasi shqyrtoi materialet e përgatitura nga organi ekzekutiv, Këshilli i Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve

VENDOSI:

1. Ti kërkojë shoqërisë së sigurimit "DUKAGJINI AL" sh.a. të autorizuar nga Autoriteti Mbikëqyrës i Sigurimeve për ushtrim aktiviteti në sigurime me nr.7, datë 8.7.2004 dhe me leje të ushtrimit të aktivitetit në sigurime nr 7/1, datë 10.9.2004, që brenda një periudhe jo më shumë se dy muaj nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi për mbulimin e përgjegjësive që rezultojnë mbi mundësitë e saj siç parashikohen nga neni 107 i ligjit të sipërpërmendur:

a) Të marrë masa për risigurimin, rritjen e kapitalit themeltar në nivelin e kërkuar dhe të depozitojë në llogarinë qëllimore fondin e kërkuar të garancisë.

b) Në rast të mospërbushjes të kërkesave të pikës 1/a, shoqëria të zgjidhë kontratat e përgjegjësive të marra, që janë në tejkalim të kërkesave të dekretit nr.107 të ligjit të sipërpërmendur.

2. Deri në momentin e ngurtësimit të fondit të garancisë sipas kërkesave të pikës 2/a të nenit 98 të ligjit nr.9267, datë 29.7.2004, shoqëria ndalohet të lidhë kontrata të reja sigurimi që i përkasin klasave 10, 11, 12, 13, 15, sipas klasifikimit të parashikuar në nenin 7 të ligjit nr.9267, datë 29.7.2004.

3. Deri në momentin e ngurtësimit të fondit të garancisë sipas kërkesave të pikës 2/b të nenit nr.98 të ligjit nr.9267, datë 29.7.2004, shoqëria ndalohet të lidhë kontrata të reja sigurimi që i përkasin klasave 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, sipas klasifikimit të parashikuar në nenin 7 të ligjit nr.9267, datë 29.7.2004.

4. Brenda 10 ditëve kalendarike nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, të emërohet Drejtori i Përgjithshëm i shoqërisë.

5. Ngarkohet shoqëria "DUKAGJINI AL" sh.a. dhe Ekzekutivi i Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi më datë 26.10.2005.

**KRYETARE E KËSHILLIT
TË AUTORITETIT MBIKËQYRËS TË SIGURIMEVE
Burbuqe Riba**

**VENDIM
Nr.41, datë 26.10.2005**

**MBI ANALIZËN E GJENDJES FINANCIARE TË SHOQËRISË SË SIGURIMEVE
"ALBSIG" SHA PËR 6- MUJORIN E PARË TË VITIT 2005**

Në mbështetje të nenit 14 të ligjit nr.9268, datë 29.7.2004 "Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve", të nenit 98, nenit 107 të ligjit nr.9267, datë 29.7.2004 "Për veprimtarinë e sigurimit, risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime", Këshilli i Autoritetit Mbikëqyrës i Sigurimeve

VENDOSI:

1. T'i kërkojë shoqërisë së Sigurimit ALBSIG sh.a. të autorizuar nga Autoriteti Mbikëqyrës i Sigurimeve për ushtrim aktiviteti në sigurime me nr.10, datë 19.7.2004 dhe me leje të ushtrimit të aktivitetit në sigurime më 10/1, datë 10.9.2004, që brenda një periudhe jo më shumë se dy muaj nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi për mbulimin e përgjegjësive që rezultojnë mbi mundësitë e saj siç parashikohen nga neni 107 i ligjit të sipërpërmendur:

a) Të marrë masa për risigurimin, rritjen e kapitalit themeltar në nivelin e kërkuar dhe të depozitojë në llogarinë qëllimore fondin e kërkuar të garancisë.

b) Në rast të mospërbushjes të kërkesave të pikës 1/a, shoqëria të zgjidhë kontratat e përgjegjëseve të marra, që janë në tejkallim të kërkesave të nenit 107 të ligjit të sipërpërmendur.

2. Në rast të mospërbushjes të kërkesave të pikës 1, shoqëria të zgjidhë kontratat e përgjegjëseve të marra, që janë në tejkallim të kërkesave të parashikuara në nenin 107 të ligjit nr.9267 "Për veprimtarinë e sigurimit, risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime".

3. Të zhblllokojë pjesën e fondit të garancisë së përdorur si kolateral për kredi të marra në banka tregtare.

4. Ngarkohet shoqëria ALBSIG sh.a. dhe Ekzekutivi i Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi me datë 26.10.2005.

KRYETARE E KËSHILLIT
TË AUTORITETIT MBIKËQYRËS TË SIGURIMEVE
Burbuqe Riba

VENDIM
Nr.42, datë 26.10.2005

MBI ANALIZËN E GJENDJES FINANCIARE TË SHOQËRISË SË SIGURIMEVE
"INTERALBANIAN" SHA PËR 6- MUJORIN E PARË TË VITIT 2005

Në mbështetje të shkronjave "d", "k" të pikës 2 të nenit 14 të ligjit nr.9268, datë 29.7.2004 "Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Mbikëqyrës së Sigurimeve" dhe të neneve 107 dhe 175 të ligjit nr.9267, datë 29.7.2004 " Për veprimtarinë e sigurimit, risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime", pasi shqyrtoi materialet e përgatitura nga organi ekzekutiv, Këshilli i Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve

VENDOSI:

1. Ti kërkojë shoqërisë së sigurimit INTERALBANIAN sh.a. të autorizuar nga Autoriteti Mbikëqyrës i Sigurimeve për ushtrim aktiviteti në sigurime me nr.9, datë 19.7.2004 dhe me leje të ushtrimit të aktivitetit në sigurime nr. 9/1, datë 10.9.2004, që brenda një periudhe jo më shumë se dy muaj nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi për mbulimin e përgjegjëseve që rezultojnë mbi mundësitë e saj siç parashikohen nga neni 107 i ligjit të sipërpërmendur:

a) Të marrë masa për risigurimin, rritjen e kapitalit themeltar në nivelin e kërkuar dhe të depozitojë në llogarinë qëllimore fondin e kërkuar të garancisë.

b) Në rast të mospërbushjes së kërkesave të pikës 1/a, shoqëria të zgjidhë kontratat e përgjegjëseve të marra, që janë në tejkallim të kërkesave të nenit 107 të ligjit të sipërpërmendur.

2. Të zhblllokojë pjesën e fondit të garancisë së bllokuar si kolateral për efekt kredie.

3. Të marrë masa për uljen e shpenzimeve operative, në masën e parashikuar sipas plan-biznesit, mbi bazën e të cilit është licencuar si shoqëri sigurimi.

4. Të marrë masa për uljen e gjendjes së *cash* në arkë, deri në nivelin 3% të provigjoneve teknike, brenda 1 muaji nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

5. Të anulojë kontratën e mbulimit me shoqërinë e sigurimit Intersig për sigurimin e pasurisë së Agjencisë Nacionale të Trafikut Ajror SHA, pasi në gjendjen aktuale kjo kontratë nuk konsiderohet bashkësigurim.

6. Deri në momentin e ngurtësimit të fondit të garancisë sipas kërkesave të pikës 2/a të nenit

98 të ligjit nr.9267, datë 29.7.2004, shoqëria ndalohet të lidhë kontrata të reja të sigurimit që i përkasin klasave 10, 11, 12, 13, 15 sipas klasifikimit të parashikuar në nenin 7 të ligjit nr.9267, datë 29.7.2004.

7. Deri në momentin e ngurtësimit të fondit të garancisë sipas kërkesave të pikës 2/b të nenit 98 të ligjit nr.9267, datë 29.7.2004, Shoqëria ndalohet të lidhë kontrata të reja sigurimi që i përkasin klasave 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8 sipas klasifikimit të parashikuar në nenin 7 të ligjit nr.9267, datë 29.7.2004.

8. Ngarkohet shoqëria INTERALBANIAN sh.a. dhe Ekzekutivi i Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi në datë 26.10.2005.

**KRYETARE E KËSHILLIT
TË AUTORITETIT MBIKËQYRËS TË SIGURIMEVE
Burbuqe Riba**

**VENDIM
Nr.43, datë 26.10.2005**

**PËR NIVELIN E FONDIT TË GARANCISË SË KËRKUAR PËR SHOQËRINË E
SIGURIMIT "INTERSIG" SHA**

Në mbështetje të shkronjave "d" dhe "k" të pikës 2 nenit 14 të ligjit nr.9268, datë 29.7.2004 "Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Mbikëqyrës së Sigurimeve" nenit 98, nenit 126, 175, pika 2 dhe nenin 107, 108 të ligjit nr.9267, datë 29.7.2004 "Për veprimtarinë e sigurimit, risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime", dekretit nr.295, datë 15.9.1992 "Për sigurimin e detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorike për përgjegjësinë ndaj personave të tretë", si dhe analizave të përgjegjësive të marra në sigurim dhe të kaluara ose jo në risigurim nga shoqëria e sigurimit INTERSIG sh.a. Këshilli i Autoritetit të Mbikqyrjes së Sigurimeve

VENDOSI:

1. Deri në momentin e lidhjes së marrëveshjes së risigurimit për produktin " Kartoni jeshil", shoqëria ndalohet të marrë në sigurim përgjegjësi që rrjedhin nga tregtimi i kontratës së kartonit jeshil.

2. Deri në momentin e ngurtësimit të fondit të garancisë sipas kërkesave të pikës 2/a të nenit 98 të ligjit nr.9267, datë 29.7.2004 "Për veprimtarinë e sigurimit, risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime", shoqëria ndalohet të lidhë kontrata të reja të sigurimit që i përkasin klasave 10, 11, 12, 13, 15, sipas klasifikimit të parashikuar në nenin 7 të ligjit 9267, datë 29.7.2004, kërkesave të pikës 2/a, të nenit 98 të ligjit nr.9267, datë 29.7.2004 "Për veprimtarinë e sigurimit, risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime".

3. Deri në momentin e ngurtësimit të fondit të garancisë sipas kërkesave të pikës 2/d, të nenit 98 të ligjit nr.9267, datë 29.7.2004 "Për veprimtarinë e sigurimit, risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime", shoqëria ndalohet të lidhë kontrata të reja të sigurimit që i përkasin klasës 14, sipas klasifikimit të parashikuar në nenin 7 të ligjit nr.9267, datë 29.7.2004.

4. Ngarkohet shoqëria Intersig sh.a. dhe Ekzekutivi i Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi në datë 26.10. 2005.

**KRYETARE E KËSHILLIT
TË AUTORITETIT MBIKËQYRËS TË SIGURIMEVE
Burbuqe Riba**

Fletorja Zyrtare gjendet:

Duke u abonuar pranë:

- njësisë postare të qyteteve;

- Qendrës së Publikimeve Zyrtare;

- në adresën:

Bulevardi Zhan d'Ark,

pranë ish-ekspozitës "Shqipëria Sot"

Tel: 042 555 63; 267 468

Përmbajtjen e Fletores Zyrtare mund ta konsultoni edhe në adresën e internetit:

www.legjislacionishqiptar.gov.al ose www.qpz.gov.al

Pranë **Qendrës së Publikimeve Zyrtare** mund të gjeni:

BOTIMET:

1.	KUSHTETUTA (edhe anglisht)	600
2.	KODI I PROCEDURËS CIVILE	500
3.	KODI PENAL DHE KODI I PROCEDURËS PENALE (Botim,2005)	700
4.	KODI I PUNËS	500
5.	KODI I FAMILJES	450
6.	KODI CIVIL (Botim, 2005)	1000
7.	KODI RRUGOR DHE LIGJ PËR TRANSPORTIN	900
8.	KODI ZGJEDHOR (i azhurnuar)	355
9.	KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE (Botim,2005)	500
10.	DISPOZITA ZBATUESE TË KODIT RRUGOR	1500

PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI

1.	PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PËRMBARIMIT	800
2.	PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PROKURIMIT PUBLIK	1000
3.	PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NËPUNËSIN CIVIL (Botim,2005)	600
4.	PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR SISTEMIN E DREJTËSISË (Botim,2005)	1500
5.	PËRMBLEDHJE NË FUSHËN E TAKSAVE DHE TATIMEVE	1500

1.	TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR 1990-KORRIK 2004	1500
2.	TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR 1990-KORRIK 2004	2000

Doli nga shtypi më 1.11.2005

Tirazhi: 4300 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja "Mësonjëtorja"
Tiranë, 2005

Çmimi 150 lekë